



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
REKTORATI

Nr. 951 prot.

Gjirokastrë, më 28.05. 2026

MIRATOI  
REKTORI

Prof. dr. Jahor Çaga



**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me rrjetin UNIADRION, Itali.

Në kuadër të Programit Erasmus+, rrjeti i universiteteve, UNIADRION, hap thirrjen për shkëmbim studentësh me universitetet italiane që janë pjesë e këtij rrjeti.

Sipas komunikimit elektronik, Universiteti i Gjirokastrës do të nominojë 8 (**tetë**) studentë që do të mund të ndjekin studimet për një semester, dy semestra ose një vit të plotë akademik gjatë vitit akademik 2025 - 2026.

Të interesuarit duhet të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **08.06.2026**, në formë fizike dhe elektronike:

- Vërtetim studenti;
- Listë notash;
- Letër interesi në anglisht;
- CV në formatin EUROPASS, në anglisht;
- Provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose italiane, minimalisht të nivelit B2;
- Fotokopje të pasaportës;

Studentët e interesuar duhet të paraqiten pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, brenda afatit të përcaktuar më sipër, për të plotësuar formularin e aplikimit. Dokumentacioni i dorëzuar do të vlerësohet paraprakisht nga një komision *ad hoc* i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor do t'ia përcjellë nominimet rrjetit UNIADRION për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

**Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë  
Projekteve dhe Kërkimit Shkencor**

Irma Gjollëshi